



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 49 Prot.

Tiranë, më datë 07.02 2019

**VENDIM**

**Nr. 34, datë 07.02.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 07.02.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit: “Depozita bregdetare me kapacitet  $3 \times 10000 \text{m}^3$ , Porto Romano, Durrës”, me subjekt aplikues “ROYAL TRADE COMPANY” sh.a..;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 144, neni 145 dhe nenit 146;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR I KKR**

**Arta DOLLANI**

